



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 179 Prot.

Gjirokastrë, më 05/02/2020

V E N D I M

Nr. 09 , datë 05.02.2020


**MIRATIMI I HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT ME SHLUJ
"UNIVERSITETI MARIN BARLETI " NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE
"BACHELOR" NË EDUKIM FIZIK E SPORTE**

Në zbatim të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ", neni 38 pika dh, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 14 pika 6 dhe pika 9, vendimit nr. 879 datë, 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 18.12.2018 , të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë " dhe udhëzimit nr. 1, datë 14. 01. 2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë " Kreu IV/A, pika 6 Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej , në mbledhjen e tij të datës, 05. 02. 2020;

V E N D O S I :

1. Të miratojë programin e përbashkët të Universitetit "Eqrem Çabej" me SHLUJ "Universitetin Marin Barleti" , në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në Edukim Fizik e Sporte, i cili realizohet me 180 ECTS në 3 (tre) vite akademike.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe një kopje e këtij vendimi i kalon Bordit të Administrimit për miratim.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK


Prof. dr Bektash MEMA

